




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 17, date 21.3.2018

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E Z.PJETER SHKAFI DHE LEKE SHKAFI, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 21.3.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie të ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Pjeter Shkafi** në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie të ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Leke Shkafi** në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës nga zjarri.
3. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile në programin 10910 parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 të miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017, në programin P13, F1 O1 A2. (transferime për individë).
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër.

5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,580,958 lekë (një milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 628,000 lekë (gjashtëqind e njëzët e tetë mijë) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjet z.Pjeter Shkafi dhe z.Leke Shkafi, në total 2,208,958 lekë (dy milion e dyqind e tetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë).
6. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e z. Pjeter Shkafi dhe z. Leke Shkafi, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
7. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 200,000 lekë.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 21.3.2018

Shpallur në datën 23.3.2018

**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**

**ZV/ KRYETAR**

